

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: Autoritetit Kontraktues – KUVENDI KOMUNAL MALISHEVË

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 625-26-7317-5-1-1

Sa i përket tenderit për “Asfaltimi i rrugëve në Fshatrat Ngucat, Bellanicë, Temeqinë, Banjë, Senik, Carravranë, Damanek, Dragobil, Drenoc, Burim, Marali, Astrazub”

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

“Flamuri V” SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. “Rilindja Kombëtare” pn.

(Adresa)

Malishevë

(Vendi)

24000

(Kodi postar)

+383 (0)49 24 44 87

(Numri Telefonit)

Vllaznim Mazreku, Drejtor Menaxhues

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

flamurivshpk@gmail.com

(Adresa elektronike)

22.09.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)


(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë dhe dosja e tenderit – 31.08.2026

Njoftimi mbi vendimin – 22.09.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kërkesa për Rishqyrtim – 16.09.2026

Vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim – 17.09.2026

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP
Neni 7 i LPP
Neni 28 i LPP
Neni 29 i LPP
Neni 69 i LPP



*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Fillimisht duhet sqaruar që ne kemi parashtruar një kërkesë për rishqyrtim ndërsa AK e ka publikuar një vendim ndaj një OE "NN". Pra fillimisht nuk jemi të sigurtë nëse AK ende ka kthyer përgjigje ndaj kërkesës tonë për rishqyrtim. Sidoqoftë, ne po e parashtrojmë këtë ankesë në OSHP duke përsëritur pretendimet e njëjta ankimore.

- Në këtë aktivitet të prokurimit është paraparë asfaltimi i disa rrugëve lokale. Megjithatë në dosjen e tenderit janë vendosur kërkesa të cilat nuk janë aspak në përputhje me natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Disa nga kërkesat kontestuese të vendosura nga AK janë formuluar si në vijim:

- 2.1. OE duhet të dëshmojë se ka autorizuar një inxhinier të diplomuar ose master Drejtimi Infrastruktura Rrugore (jo bachelor), të jetë i paisur me licencë A (të lëshuar nga OIRK) për menaxher të Projektit, **kërkohej të ketë min. 10 vite përvojë pune** pas diplomimit – angazhime profesionale.
 - *Kjo kërkesë është e paarsyeshme sepse 10 vite përvojë të punës pas diplomimit janë absolutisht të panevojshme për të realizuar një projekt të tillë. Kufizimi përkatës është diskriminimi apo favorizimi qëndron te fakti që ekzistojnë një numër shumë i vogël i inxhinierëve të tillë me licensë A që i kanë mbi 10 vite përvojë pas diplomimit. I njëjti staf profesional me 5 vite përvojë mund të garantojë rezultatin identik në mënyrë efektive.*
- 2.2. OE duhet të dëshmojë se ka autorizuar një inxhinier të diplomuar ose master Drejtimi Konstruktiv, të jetë i paisur me licencë A (të lëshuar nga OIRK) i certifikuar me **IWS (International Welding Specialist)**, të jete i certifikuar për Siguri në kanterin e ndërtimit, për organizim dhe menaxhim të kanterit të ndërtimit, si dhe të jete i trajnuar për dhenje të ndihmes së parë (jo bachelor), kërkohej të ketë min. 10 vite përvojë pune – angazhime profesionale pas diplomimit.
 - *Kjo kërkesë është e kundërligjshme për disa arsye. Fillimisht janë kërkuar disa kualifikime për një person të caktuar. Kualifikimet e caktuara mund të kërkojnë për OE dhe jo për një staf të caktuar individualisht. Pra përveç kualifikimeve si inxhinier me licensë A janë kërkuar edhe 4 certifikata tjera si dhe 10 vite përvojë pas diplomimit. Natyrisht që një kufizim i tillë përbën diskriminim/favorizim të drejtpërdrejtë. Mirëpo problemi më i madh shpërfaqet te kërkesa për të qenë i certifikuar me IWS (International Welding Specialist). Kjo për arsye se në fillim të kërkesës thuhet që OE duhet të prezantojë një Inxhinier Master me licensë A të ndërtimit drejtimi konstruktiv. Pra cila është logjika që inxhinieri i ndërtimit të ketë një certifikatë specifike për saldim kur dihet se saldimi nuk është as detyrë e inxhinierit të ndërtimitarisë. Nuk duam të besojmë që AK po mendon të detyrojë*



inxhinierët me licensë A të kryejnë punë të saldimit në punishte. Sidoqoftë, nëse AK mendon që sipas projektit dhe paramasës do të nevojiten të realizohen punë të saldimit, atëherë mund të kërkojë një saldues. Mirëpo jo të kërkojë certifikata IWS apo të tjera të cilat nuk lëshohen fare në Republikën e Kosovës dhe as që janë të njohura nga institucionet e Republikës së Kosovës.

- 2.3. OE duhet të dëshmojë se ka autorizuar një inxhinier të diplomuar ose master **Drejtimi Mbrojtje e Mjedisit (jo bachelor), të jetë i paisur me licencë A (të lëshuar nga OIRK),** të jetë i certifikuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor të Republikës së Kosovës për Mbrojtje të Mjedisit. **Të jetë i certifikuar me VSM (Hartimin e vlerimit strategjik mjedisor për planet hapsinore), të jetë i certifikuar me ISO 14001 2013 si dhe ISO 31000 2018,** të jetë i certifikuar nga Ministria e punës dhe mirëqenies sociale nga fusha e Sigurisë dhe shëndetit në punë. Kërkohet të ketë min. 10 vite përvojë pune – angazhime profesionale pas diplomimit.
 - *Kjo kërkesë është e kundërligjshme për disa arsye. Fillimisht është kërkuar një inxhinier për mbrojtje të mjedisit me licensë A, i cili edhe ashtu është absolutisht i panevojshëm për projektin në fjalë. Nuk duhet harruar që projekti ka të bëjë me asfaltimin e disa rrugëve lokale dhe nuk ka të bëjë me ndërtimin e komplekseve banesore shumëkatëshe! Tutje, janë kërkuar disa kualifikime për një person të caktuar. Kualifikimet e caktuara mund të kërkojnë për OE dhe jo për një staf të caktuar individualisht. Kërkesa për VSM është totalisht absurde për faktin se Vlerësimi Strategjik Mjedisor mund të bëhet në fazën e projektimit dhe jo në fazën e ekzekutimit. Pra OE i kontraktuar do të ekzekutojë projektin që e ka hartuar vet AK. Rrjedhimisht inxhinieri i mjedisit i certifikuar me VSM nuk ka asnjë punë të vetme gjatë ekzekutimit të projektit. Ngjashëm vlen edhe për certifikimet ISO 14001 2013 dhe ISO 31000 2018. Kërkesat për sigurimin e cilësisë mund t'i parashtrohen OE por jo një punonjësi të specifikuar. ISO 14001:2013 ka të bëjë me menaxhimin e mjedisit ndërsa ISO 31000:2018 ka të bëjë me menaxhimin e riskut. As njëra dhe as tjetra nuk janë të nevojshme për realizimin e projektit.*
- 2.4. OE duhet të dëshmojë se ka autorizuar një inxhinier të diplomuar ose master **Drejtimi Menaxhimi i Emergjencave (jo bachelor), i certifikuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të Republikës së Kosovës për Siguri dhe Shëndet në punë, si dhe nga AME për mbrojtje nga zjarri. Kërkohet** të ketë min. 10 vite përvojë pune - angazhime profesionale pas diplomimit.
 - *Kjo kërkesë është e kundërligjshme për disa arsye. Fillimisht është kërkuar një inxhinier për menaxhimin e emergjencave, i cili edhe ashtu është absolutisht i panevojshëm për projektin në fjalë. Nuk duhet harruar që projekti ka të bëjë me asfaltimin e disa rrugëve lokale dhe nuk ka të bëjë me sigurimin fizik të objekteve apo kamera të sigurisë! Tutje, janë kërkuar disa kualifikime për një person të caktuar. Kualifikimet e caktuara mund të kërkojnë për OE dhe jo për një staf të caktuar individualisht. Kërkesat për certifikatë nga MPMS për SSHP dhe nga AME për mbrojtje nga zjarri janë thjeshtë kërkesa kufizuese të cilat nuk kanë ndonjë ndikim në efikasitetin apo efektivitetin e projektit por shërbejnë vetëm për diskriminim/favorizim të një OE të caktuar në këtë aktivitet të prokurimit.*
- 2.5. OE duhet të dëshmojë se ka autorizuar një inxhinier të diplomuar ose master **Drejtimi Hidroteknikë (jo bachelor), të jetë i paisur me licencë A (të lëshuar nga OIRK), i certifikuar me VNM (Vlerësimin e ndikimit të mjedisit),** kërkohet të ketë min. 10 vite përvojë pune – angazhime profesionale pas diplomimit.



- *Kjo kërkesë është e kundërligjshme për faktin Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis mund të bëhet në fazën e projektimit dhe jo në fazën e ekzekutimit. Pra OE i kontraktuar do të ekzekutojë projektin që e ka hartuar vet AK. Rrjedhimisht inxhinieri i mjedisit i certifikuar me VSM nuk ka asnjë punë të vetme gjatë ekzekutimit të projektit. Pjesa më e palogjikshme është pse kërkohet që inxhinieri hidroteknik të jetë i certifikuar me VNM!*
- 2.6. OE duhet të dëshmojë se ka autorizuar një inxhinier të diplomuar ose master **Drejtimi Gjeologji (jo bachelor), të jetë i paisur me licencë A (të lëshuar nga OIRK), i certifikuar me VNM** (Vlerësimin e ndikimit të mjedisit), kërkohet të ketë min. 10 vite përvojë pune –angazhime profesionale pas diplomimit.
 - *Kjo kërkesë është e kundërligjshme për faktin Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis mund të bëhet në fazën e projektimit dhe jo në fazën e ekzekutimit. Pra OE i kontraktuar do të ekzekutojë projektin që e ka hartuar vet AK. Rrjedhimisht inxhinieri i mjedisit i certifikuar me VSM nuk ka asnjë punë të vetme gjatë ekzekutimit të projektit. Pjesa më e palogjikshme është pse kërkohet që gjeologu të jetë i certifikuar me VNM! Përndryshe as gjeologu nuk është fare i nevojshëm për një projekt ku do të asfaltohen disa rrugë lokale. Kjo pasi që nuk kemi të bëjmë me gërmime apo me ndërtime por me asfaltim.*
- 2.7. OE duhet të dëshmojë se ka autorizuar një inxhinier të diplomuar **Drejtimi Gjeodezi ose master (jo bachelor), i licencuar me licence valide nga AKK, certifikuar për GIS,** kërkohet të ketë min. 6 vite përvojë pune –angazhime profesionale pas diplomimit.
 - *Kërkesa për gjeodet është e panevojshme aq më pak i certifikuar për GIS pasi që ekzekutimi do të sipas specifikave që janë ekskluzivisht të përcaktuara në projektin e AK.*
- 2.8. OE duhet të dëshmojë se ka autorizuar një bachelor të diplomuar **Drejtimi Gjeodezi, të jetë i paisur me licencë AKK. Duhet të jetë i trajnuar për përdorimin e dronëve gjeodezik me sistem lidar nga prodhuesi apo distributori. Si dhe kërkohet të ketë certifikatë ku dëshmohet se ka kaluar me sukses testin e njohurive sipas Rregullores (ACC) nr.01 2017 për operim të mjeteve Ajrore Pa pilot(SAP) nga Autoriteti i Aviacioni Civil të Kosovës min. 3 vite përvojë pune –angazhime profesionale pas diplomimit.**
 - *Kjo kërkesë është absolutisht e kundërligjshme nga të gjitha këndvështrimet e mundshme. Fillimisht përdorimi i dronëve në këtë projekt nuk është i nevojshëm dhe ky fakt nuk është fare i kontestueshëm. Tutje mënyra se si është formuluar kërkesa, është diskriminim i hapur për shumicën absolute të OE që merren me asfaltimin e rrugëve dhe në këtë rast favorizohet vetëm një OE i cili e plotëson këtë kriter. Pra kërkesa është hapurazi e përshtatur për një OE të caktuar.*
- 2.9. OE duhet të dëshmojë se ka autorizuar një inxhinier të diplomuar ose bachelor **Drejtimi Komunikacion, të jetë i paisur me licencë A (të lëshuar nga OIRK),** kërkohet të ketë min. 5 vite përvojë pune – angazhime profesionale pas diplomimit. (Vërejtje Për stafin nëse shkollimi është kryer jashtë Kosovës diploma e fakultetit duhet të jetë e nostrifikuar konform ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës, **gjithashtu minimum 4 nga stafi i prezantuar duhet të jenë të certifikuar me FIDIC**).
- *Kërkesa për 4 persona të certifikuar me FIDIC është absolutisht e kundërligjshme. Fillimisht Kosova nuk është fare anëtare e FIDIC. Së dyti këto kërkesa nuk lëshohen*



fare nga institucionet e RKS. Së treti nuk ka asnjë shpjegim pse 4 persona të tillë duhet të jenë të certifikuar me një certifikatë që nuk aplikohet fare në RKS. Prandaj kjo kërkesë është hapurazi diskriminuese/favorizuese.

- Kërkesa 4. Lista e stafit mbështetës të angazhuar në projekt; Një listë prej së paku Minimum 60 puntorë, të gjithë duhet të jenë të certifikuar për siguri në punë dhe mbrojtje nga zjarri (për shkak të natyrës së rrezikshmërisë së punës). Minimum 1 person të certifikuar për menaxher punishte Minimum 1 person të certifikuar për manipulues të makinerive të rënda. Minimum 1 person të certifikuar për kranist (vinç). Minimum 1 person të certifikuar për kontroll të cilësisë së armimit. Minimum 2 persona të certifikuar për armim. Minimum 1 person të certifikuar për drenazhim të dheut dhe për trajtimin e mbetje të rrezikshme inerte. Minimum 1 person të certifikuar për kanalizim. Minimum 1 person të certifikuar për elektroinstalues. Minimum 2 persona të certifikuar për latues. Minimum 2 persona të certifikuar për saldues.
- Kjo kërkesë është absolutisht e kundërligjshme për disa arsye. Fillimisht në këtë projekt nuk ka fare hapësirë për 60 punëtorë që të angazhohen njëkohësisht. Aq më pak nuk ka asnjë nevojë që të gjithë ata të jenë të certifikuar për SSHP. Tutje AK ka kërkuar që të prezantohen persona të certifikuar për menaxher punishte, kranist, kontroll të cilësisë së armimit, 2 për armim, drenazh të dheut, trajtim të mbetjeve inerte, kanalizim, elektroinstalues, latues dhe saldues. Mirëpo AK nuk ka treguar se kush duhet të jetë autoriteti certifikues për këta punonjës. Njëkohësisht nuk ka asnjë ndërlidhje në mes të këtij stafit dhe paramasës/projektit.

Lista e pajisjeve komplet është e formuluar gabimisht. Në fakt, lista e pajisjeve sikurse lista e stafit, është e përshtatur ekskluzivisht për një OE të caktuar.

Me shumë respekt e konfirmojmë që ne si OE do të shfrytëzojmë të gjithat mjetet juridike në dispozicion administrative, civile dhe/apo penale për të mbrojtur të drejtat e garantuara me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik. Prandaj shpresojmë shumë në mirëkuptimin e AK për të larguar kërkesat e kundërligjshme nga DT duke eliminuar të gjithat kufizimet diskriminuese/favorizuese si dhe duke hapur konkurrencën sipas ligjit.

Nga sa u tha më sipër kërkojmë nga AK që të merr këtë:

VENDIM

MIRATOHET si e bazuar në tërësi ankesa e OE "Flamuri V" Sh.P.K. kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit.

DETYROHET AK që të publikoj formularin B54 për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara përmes të cilit korrigjohet dosja e tenderit ashtu që ndryshon-plotësohen dhe/apo largohen nga dosja e tenderit kërkesa e elaboruara si më sipër në këtë ankesë.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Do të precizohen.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:



- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.

